




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE TIK "HERMANN GMEINER", TIRANË

Nr/20 Prot.

Tiranë më 15 / 10 / 2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të Ligjit Nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerezore, perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit", i ndryshuar

-Shkolla e Mesme Profesionale TIK "Hermann Geminer", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

-1 (një) mësimdhënës i Teorisë Profesionale, të drejtimit Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme,

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë të punës si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësues të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të kërkuar;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- g) letërmotivimin për pozicionin;
- h) jetëshkrimin (CV-në);
- i) kartën e identitetit;
- j) diplomën;
- k) librezën e punës;
- l) cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- m) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- n) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- o) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- p) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- q) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- r) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës

22/10 /2025.

3.Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr.759, datë Nr.759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit”, i ndryshuar .

DREJTORE


HEDIE GJONI

